VENDIM
Nr.529, datë 27.4.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.495, DATË 1.8.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHTESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SHTETET E HUAJA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.495, datë 1.8.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që i përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtën numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.3, që i përmendet në pikën 8, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.3/1, që përmendet në pikën 9, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të këtij viti, të planifikuara për politikën e pagave.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

PAGA MUJORE E PERSONELIT DIPLOMATIK TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKëS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	paga mujore	
	Paga bazë mujore (në euro dhe në dollarë USD)	Shtesa për përfaqësimin (në %)
Ambasador	1250 euro 1520 dollarë USD	75%
Konsull i Përgjithshëm Ministër Fuqiplotë Ministër Këshilltar	690 euro 1165 dollarë USD	75% 40% 40%
Këshilltar	805 euro 1020 dollarë USD	40%
Sekretar i parë Konsull	660 euro 815 dollarë USD	40%
Sekretar i dytë Zëvendëskonsull	505 euro 650 dollarë USD	40%
Sekretar i tretë Agjent Konsull	455 euro 560 dollarë USD	40%
Atashe	405 euro 505 dollarë USD	40%

Lidhja nr.3

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PLOTË), TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	Paga mujore				
	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4	Grupi 5
Sekretar teknik Financier Specialist	820 euro 920 dollarë USD	780 euro 885 dollarë USD	750 euro 850 dollarë USD	725 euro 830 dollarë USD	670 euro 780 dollarë USD
Shofer	780 euro 885 dollarë USD	740 euro 840 dollarë USD	705 euro 810 dollarë USD	680 euro 790 dollarë USD	630 euro 735 dollarë USD
Kafaz	650 euro 715 dollarë USD	610 euro 670 dollarë USD	575 euro 640 dollarë USD	545 euro 610 dollarë USD	500 euro 560 dollarë USD

Lidhja nr.3/1

PAGA MUJORE E PERSONELIT ADMINISTRATIVO-TEKNIK (ME KOHË TË PJESSHME), TË PËRFAQËSIVE DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË SHTETET E HUAJA

Pozicioni	Paga mujore (me kohë të pjesshme)	
	Minimumi	Maksimumi
Sekretar teknik Financier Specialist	290 euro 320 dollarë USD	440 euro 490 dollarë USD
pastrues	220 euro 240 dollarë USD	295 euro 325 dollarë USD